




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 05.05.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 16.2 dhe nenit 20, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-22-9573-2-2-1, numër të brendshëm 632-22-097-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-26602, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Autoritetit kontraktues, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 05.05.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Autoritetit kontraktues, Kontrata me numër të prokurimit: 632-22-9573-2-2-1, numër të brendshëm 632-22-097-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-26602, e datës 22.11.2022, për realizimin e kontratës : "Organizimi i festave tradicionale në Komunën e Gjakovës", e lidhur mes në mes të AK Komuna e Gjakovës dhe OE N.T.P. " LIVING STUDIO", me seli në Prishtinë, NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale që dalin nga kontrata, me numër të prokurimit: 632-22-9573-2-2-1, numër të brendshëm 632-22-097-221 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-26602, e datës 22.11.2022, në pajtim me nenin 16.2 dhe nenin 20, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), kërkesës Kontraktuesit dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e porositësit, ka iniciuar aktivitetin për “Organizimi i festave tradicionale në Komunën e Gjakovës”, të dt. 22.11.2022, me O.E : N.T.P. " LIVING STUDIO", me seli në Prishtinë, për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zytari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 01nr.112/02-3895 të dt. 21.02.2023, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte te Menaxherit të Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 20.04.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës .

Me date 04.05.2023, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për shkëputje me marrëveshje te kontratës” te OE N.T.P. " LIVING STUDIO", me seli në: Prishtinë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
Drejtorisë për Shërbime Publike
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.